*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të*
*Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*
*Dt.20.03.2023*

**20.03.2023**
**Ora, 18:11**

***RENDI I DITËS***

***Hedhja e shortit "Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 36 me objekt, "Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 179, dt.18.03.2023 dhe ndryshimin e këtij vendimi , duke vendosur: Pezullimin e regjistrimit të subjektit "Partia Demokratike" me nënkryetar zotin Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar , për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim ërfundimtar për ankimin e subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë" e përfaqësuar nga kryatari zoti Sali Berisha"***

**PJESËMARRJA :**

- **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj.**

***Z. Y. Merkaj:*** Përshëndetje të gjithëve! Sot do të zhvillohet procedura e caktimin e relatorit, për Kërkesën Ankimore nr. 36, të paraqitur në KQZ, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt "Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 179, dt.18.03.2023._Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërën prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 36, 4 shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat pasi palosen nga një përfaqësues i KQZ-së, futen në 5 gogla me peshë , ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Pasi janë futur 5 goglat në enë transparente përzjehen nga një përfaqësues i KQZ-së. Duke qenë se anëtarët e Kas-it nuk janë të pranishëm, është autorizuar përfaqësuesi i KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre goglat

për caktimin e relatorit. Vazhdojmë me rendin alfabetik rritës duke filluar nga zoti Elvin Lako.

***Për Z. E. Lako:*** Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

***Për Z. E. Çefa:*** Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

***Për Z. I. Rusmali:*** Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

***Për Z. K. Bele:*** Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

***Për Z. L. Braho:*** Tërhiqet gogla - Kërkesa Ankimore nr. 36.

Në përfundim të procedurës së shortit, zoti Ledio Braho është relator i Kërkesës Ankimore nr. 36. Ju faleminderit!

***Zbardhi materialin audio***
***Arlinda BAHOLLARI***